



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme -Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Policinë e Kosovës, Nr. 04/L-076, Rregulloren (MPB) Nr.02/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës, Udhëzimin Administrativ 02/2023 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës neni 26, si dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 16/02/2026 me nr ref: 10/1-01/040/2026, Policia e Kosovës shpall:

K O N K U R S

Datë: 07.04.2026

Referenca: 10/1-01/SRS/073/2026

Për plotësimin e vendit të punës

1. **Titulli i vendit të punës:** Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Objekteve (ESM Gjenerator)
- tri (3) vende të lira pune

Vendi i punës: Ekipi i Specialistëve të Makinerisë për Gjenerator/Njësia e Specialistëve të Gjeneratorëve / Sektori i Mirëmbajtjes / Drejtoria e Menaxhimit të Objekteve

Klasa: Profesional 1

Koeficienti: 6.7

Bazuar ne Ligjin nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës se Kosovës nenit 31 paragrafi 1 për vitin 2026 mbetet në fuqi për vitin fiskal 2026 rritja e koeficientit të pagës për një (1) njësi të bërë me Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025 për të gjitha klasat e pozitave sipas Shtojcave 1 - 15 të Ligjit Nr. 08/L-196 të Pagave në Sektorin Publik.

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të pa caktuar

Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mirëmbajtjen dhe servisimin e vazhdueshëm të gjeneratorëve në lëmin e makinerisë;
- Bën instalimin e sistemit të ri të gjeneratorëve, me derivate të naftës;
- Bën riparimin e defekteve të cilat paraqiten në gjenerator, në të gjitha objektet e PK-së;
- Bën adaptimin e instalimeve në përputhshmëri me veprimtaritë që zhvillohen në hapësirat përkatëse;
- Grumbullimin e të dhënave për gjendjen e gjeneratorëve, në të gjitha objektet e PK-së;

- Pastrimi i gjeneratorëve, në mënyrë gjeneralë;
- Kontrollimin e punës së gjeneratorëve në të gjitha objektet e PK-së;
- Ndhmon teknikët e elektros për gjenerator;
- Është përgjegjësi dhe detyre që gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare të angazhohet në mbledhjen e informatave të inteligjencës nga të gjitha burimet në dispozicion;
- Kryen edhe punë tjera që ia përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe dhe të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.

Shkollimi i kërkuar dhe shkathtësitë:

- Shkollim i mesëm i paspecifikuar (Çertifikatë për profesionin e kërkuar);
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Çertifikatë të kryerjes së trajnimit përkatës, apo dëshmi të kryerjes së punëve të tilla;
- Aftësi profesionale dhe motivuese;
- Posedim të standardeve të larta etike;
- Të ketë shkathtësi të organizimit;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara të komunikimit me shkrim dhe me gojë;

Kerkese shtesë:

- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- E dëshirueshme të ketë patentë shoferë;
- Të ketë gatishmëri për punë me orar të zgjatur.

Kërkesat e përgjithshme për pranim janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike;
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimin.

Forma e aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet në dy mënyra:

1. Aplikimi online ose
2. Aplikimi në formë fizike.

1. **Aplikimi online** bëhet përmes ueb faqes zyrtare të PK-së:
www.kosovopolic.com/Shpallje/Mundësi_punësimi.

Në aplikimin online duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- a) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
 - b) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
 - c) E dëshirueshme të ketë kopjen e patentë shoferit;
 - d) Certifikata e Gjendjes Penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
 - e) Një fotografi të formatit (5 x 5).
2. **Aplikimi në formë fizike** - Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Në aplikimin në formë fizike duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- a) Formulari për aplikim se bashku me Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com;
- b) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
- c) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- d) E dëshirueshme të ketë kopjen e patentë shoferit;
- e) Çertifikata /ekstraktin e lindjes (jo me i vjetër se 6 muaj);
- f) Çertifikata e gjendjes penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
- g) Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- h) Një fotografi të formatit (5 x 5).

Formularët duhet t'i dorëzohen në Sektorin për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Sektori për Rekrutim dhe Seleksionim, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet.

Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë. Kandidatët që kalojnë testin me shkrim do t'i nënshtrohen intervistës. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Kandidatët të cilët kanë ndonjë vërejtje në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit për çdo fazë të testimit, kanë të drejtë të ankohen.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo faze të testimit do të bëhet përmes publikimit të listave në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data **07.04.2026** deri me **22.04.2026**.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038- 5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751dhe 038 245 184 si dhe në adresën elektronike rekrutimi@kosovopolic.com.

“Policia e Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe personat me aftësi të kufizuara”.